



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 17 tetor 2016, në mbledhjen e XXXII-të
(tridhjetedy), e jashtëzakonshme, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti përkatësisht Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekalio, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe Muharrem Haziri, OSBE.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, në vazhdim theksoi, vizita zyrtare në Shqipëri – Sarandë është planifikuar të bëhet më 20 tetor 2016 dhe shtoi, rruga është mjaftë e gjatë dhe do të ishte mirë që bashkërisht të caktojmë kohën e nisjes.

z. Fidan Rekalio, theksoi, ne e kemi mbështet propozimin për vizitën zyrtare në Sarandë, mirëpo unë nuk kam informacione për kohëzgjatjen e kësaj vizite.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, z. Mrika Thaçi ka kontaktuar me kryetaren e Bashkisë së Sarandës dhe sipas marrëveshjes ne do të takohemi me kryetaren e Bashkisë dhe kryetaren e Këshillit të Bashkisë së Sarandës më 21 tetor 2016 dhe sipas planifikimit vizita do të jetë katër ditore, kuptohet duke e llogaritur edhe udhëtimin.

Konsideroj se në mungesë të këshilltarëve do të ishte mirë që pjesëmarrës të vizitës të jetë edhe stafi i Zyrës Ligjore, të cilët janë të angazhuar në punët e Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, e mbështes propozimin e kryesuesit dhe jam i mendimit se stafi i Zyrës Ligjore duhet të përfshihet në këtë vizitë ngase i njëjti është i angazhuar në punët e Kuvendit dhe Komiteteve të Kuvendit, pra ai është gjithëherë me ne.

Pas propozimeve njëzëri u vendos që nisja për vizitë të bëhet më 20 tetor 2016 në orën 9,00’.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, jeni në dijeni se z. Mrika Thaçi është emëruar drejtoare e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe se ka dhënë dorëheqje të paravokueshme nga këshilltarja e Kuvendit të Komunës.

Në bazë të kësaj janë zhvilluar procedurat për zëvendësimin e të njëjtës dhe ka arritur Vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor sipas të cilit z. Mrika Thaçin e zëvendëson z. Tringa Sfishta, nga koalicioni zgjedhor AAK – LDD dhe nëse pajtoheni ne do ta ftonim z. Tringa Sfishtën, që të jep betimin solemn në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e cila do të mbahet më 18 tetor 2016.

Propozimi i kryesuesit u miratua njëzëri.

Rendi i ditës

- Propozimi i Vendimit për rialokimin e një pjese të mjeteve buxhetore të komunës së Podujevës në vitin 2016

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, drejtori z. Isuf Latifi, e sqaroi dhe arsyetoi në detaje nevojën për rialokimin e mjeteve buxhetore përkatëse dhe duke u bazuar se për këtë çështje do të debatohet edhe në mbledhjen e nesërme të jashtëzakonshme të Kuvendit, nuk e shoh të arsyeshme të diskutoj por propozoj që Kuvendit t'i rekomandohet për shqyrtim.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sqarimet janë të nevojshme siç është rasti që mjetet përkatëse nga projekti për blerjen e një mamografi, ridestinohen për ndërtimin e objekteve ndihmëse etj, nëse drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e ka paraparë si projekt me prioritet kur realisht dihet rëndësia e atij aparati në aspektin e shëndetësisë, shtrohet pyetja përse mjetet e atij projekti rialokohen në projekte të tjera.

z. Haki Rudari, theksoi, në parim e përkrahim propozimin e këtij vendimi, mirëpo konsideroj se nuk është në rregull që të rialokohem mjetet nga projekti, asfaltimi i rrugës Herticë – Surdull, kodi 43151, shuma 50,021 €, ngase atje ka nevojë edhe për këtë por edhe për projekte të tjera.

Disa ditë më parë rastësisht jam takuar me drejtorin e QKMF – së dhe ai më tha se është blerë mamografi, mirëpo vërejtja se është propozuar që të rialokohen mjete për ndërtimin e objekteve ndihmëse për QMF, në këtë projekt ka pasë mjete andaj nuk jam në dijeni përse rialokohen për këtë qëllim kur ka disa sektor më të rëndësishëm.

Sa i përket infrastrukturës është kërkesë e banorëve të lagjes Sinani në Shajkoc të cilët kanë probleme për shkak të mungesës së kanalizimit fekal dhe jam i interesuar të di se a ka mundësi të zgjidhet kjo çështje.

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, sa i përket çështjes të cilën e ngriti z. Rafet Llapashtica, ju njoftoj se mamografi është blerë, pra ky projekt është realizuar dhe mjetet e parapara për rialokim janë mjete tepricë. Ndërsa sa i përket shqetësimit të z. Haki Rudarit mund të them se është plotësim i kontratës ku hynë edhe renovimi i dhomës së rëntgenit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, sa i përket asfaltimit të rrugës Herticë – Surdull në gjatësi afro 7 – 8 km. që është propozuar të hiqen mjetet nga ky projekt, ju informoj se janë zhvilluar biseda dhe çështja është para nënshkrimit të memorandumit me Ministrinë e Infrastrukturës e cila do ta financoj këtë projekt.

z. Kadri Avdiu, theksoi, nuk jam në dijeni se a i është drejtuar një kërkesë drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, lidhur me gjendjen shumë të vështirë të një rruge në Tërnavë, përkatësisht lagjen e Kuletëve të Vanovcit e cila është pothuajse e pakalueshme, në veçanti kur bie shi, andaj propozoj që të shqyrtohen mundësitë për shtruarjen me zhavorr të asaj rruge.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, Kuvendit i rekomandohet njëzëri për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 13.20'.

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01- 006-79978

**Podujevë,
17 tetor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**